REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2026

VENDIM

Nr. 513, datë 29.10.2026

PËR
MIRATIMIN E STUDIMIT PËR RISHIKIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË GJYQTARËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 147 dhe 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 61 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, nenet 14, 15, pika 3, shkronja "b", 21, 22 dhe 90 të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozim të anëtarëve, z. Markelian Koça, znj. Emona Muçi dhe z. Albens Tabaku,

VENDOSI:

1. Miratimin e studimit për rishikimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Përcjelljen e studimit të miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, Këshillave të Gjykatës, Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave për marrjen e mendimit mbi propozimet e paraqitura në të.
3. Konsultimin me palë të tjera të interesuara, sipas rregullave të parashikuara në ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARI

ILIR RUSI